

URDHËR
Nr. 1131, datë 27.12.2024

**PËR MARRJEN E MASAVE KUFIZUESE PËR PARANDALIMIN DHE
KONTROLLIN E SËMUNDJES SË MURTAJËS AFRIKANE TË DERRAVE NË
KAFSHËT E GJALLA TË LLOJIT DERRA TË BUTË, NË MJEDISËT E HAPURA
DHE NË TREGJET E KAFSHËVE TË GJALLA**

Mbështetur në nenin 102, pika 4, të Kushtetutës; në shkronjën “b” të nenit 15 dhe në nenin 21 të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; në urdhrin nr. 241, datë 30.7.2012, “Për miratimin e rregullores mbi kontrollin e sëmundjes së murtajës afrikane të derrave”; në planin e kontigjencës nr. 10390/1 prot., datë 24.11.2020, “Për sëmundjen e murtajës afrikane të derrave”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e tregtimit të derrave të gjallë në mjediset e hapura dhe tregjet e kafshëve të gjalla, në territorin e Bashkisë Lezhë.
 2. Ndalimin në territorin e Bashkisë Lezhë të lëvizjes së derrave të gjallë nga ferma në fermë, dhe nga ferma në tregje, panaire dhe ekspozitat e kafshëve të gjalla.
 3. Veterineri zyrtar mund të autorizojë me miratim të titullarit të Drejtorisë Rajonale të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, lëvizjen e derrave për mbarështim, vetëm nga fermat pa prezencë të sëmundjes që ndodhen në zonën e mbrojtjes, për në thertoren më të afërt brenda zonës së mbrojtur ose në zonën e mbikëqyrur kur nuk është e mundur që kafshët të theren në zonën e mbrojtur.
 4. Të kryhet inventarizimi dhe gjurmimi me teste laboratorike konfirmatore për sëmundjen e Murtajës Afrikane të Derrave në zonat e mbrojtjes dhe mbikëqyrjes, në njësitë administrative: Shëngjin, Kolsh, Zejmen, Lezhë, Balldre, Kallmet dhe Shënkoll të Bashkisë Lezhë.
 5. Të forcohet marrja e masave për kontrollin e lëvizjes së kafshëve, zbatimin e masave të biosigurisë dhe masave sanitaro-veterinare në zonën e mbrojtjes dhe mbikëqyrjes në Njësitë Administrative Shëngjin, Kolsh, Zejmen, Lezhë, Balldre, Kallmet dhe Shënkoll.
 6. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.
- Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
Anila Denaj